



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

01. nr. 031 - 256287 , më 27.09.2016

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 10 dhe 11 të Vendimit për kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve, 01. nr. 031 - 112404, të dt. 12.05.2014, dispozitave të nenit 53 të Statutit të Kosovës së Prishtinës me, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës me 27.09.2016, merr këtë

V E N D I M

I. Caktohet komisioni për shqyrtimin e kërkesave për subvencione, nga fusha e kulturës në lëmin muzikë, ekspozita dhe manifestime.

II. Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi është në këtë përbërje:

1. Lindita Hajdari, kryetare
2. Burbuqe Berisha, anëtare
3. Alisa Gojani Berisha, anëtare
4. Ilir Bajri, anëtar
5. Diellza Sylejmani Veseli, anëtare

III. Detyrat e komisionit të cekur në pikën II të këtij Vendimi janë: të mblidhet së paku një herë në tre muaj dhe të shqyrtoj kërkesat, që kanë arritur për tre mujorit përkatës, dhe ti propozojnë Kryetarit kërkesat/ projektet të cilat duhet të mbështeten deri në shumën që është caktuar për tremujorit përkatës.

IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij Vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

I'u dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit,
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.



Kryetari i Komunës
Shpend Ahmeti